

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT
KORCE

V E N D I M

Nr 39 Date 13.06.2007

PER MIRATIMIN E BILANCIT TE VITIT 2006 DHE BIZNES PLANIN E
VITIT 2007

Keshilli I Bashkise se Qytetit Korce ,I mbledhur ne daten e sotme ,mbasi morri ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tregut te Shitjes me Shumice te Fruta-Perime “Per miratimin e bilancit te vitit 2006 dhe biznes planin e vitit 2007 “si dhe diskutimin dhe miratimin e raportit te Eksperteve Kontabel per kontrollin ligjor te llogarive te vitit 2006 Z.Bashkim Gjata dhe Dhimiter Pano , bazuar ne ligjin Nr 8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore “neni 32,pika dh,ne ligjin Nr 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”si dhe rregullave te percaktuara ne statutin e Shoqerise ,pasi shqyrtoi kete relacion te paraqitur nga Drejtoria e Shoqerise ne lidhje me bilancin e vitit 2006 dhe biznes planin e vitit 2007 mbeshtetur ne kopetencat qe ka si dhe mbas diskutimit te anetarve:

V E N D O S I

1. Te miratoje madhesine e shpenzimeve te realizuara gjate vitit 2006 nga aktiviteti I Shoqerise ne masen prej 14 205 898 leke.
2. Te miratohet vlere e te ardhurave ne masen prej 15 059 324 leke me nje rezultat fitimi bruto ne masen prej 853 426 leke dhe mbi kete shume llogaritet Tatim Fitimi ne masen 20% e cila eshte ne masen 250 347 leke nga e cila eshte derdhur ne shtet.

3. Te miratohet Raporti I Eksperteve Kontabel te Autorizuar Z.Bashkim Gjata dhe Dhimiter Pano.
4. Per vlerat e amortizimit te llogaritur per efekt te shpenzimeve ,miratohet normat ligjore ne masen 5% per ndertimet,20% paisje zyre dhe 25% paisjet kompjuterike te cilat kapin vleren 5 294 082 leke.
5. Per fitimin neto ne bilanc ne masen 603 079 leke, I cili do vazhdoje ne pozicioni e caktuar te llogarise si fitime te pashpermdara dhe te mos shperndahen si dividend per ortakun, por te riinvestohet ne shoqeri, per persosjen e infrastructures se brendeshme simbas akt-mareveshjes.
6. Lidhur me kapitalin themeltar te shoqerise ne shumen 2 000 000 leke i kerkuar dhe i paderdhur ne debit e llogarise 456 te vazhdoje te qendroje net e njejtin pozicion llogarie. Kurse per vleren e investimit te realizuar ne shoqeri si truall e terrene, ndertesa, makineri e paisje, iventar ekonomik, i rregjistruar ne Aktivet e Qendrueshme te Trupezuara simbas raportit te eksperteve te vleresimit te vleresimit te kontributit Z.Bashkim Gjata dhe Dhimiter Pano, per shumen 147 523 918 leke dhe kjo vlere duke qene kontribut ne natyre i investuar ne shoqeri , duhet te vazhdoje te perfundoje ne zmadhimin e kapitalit nga Kompania e Auditimit UNION AB Sh.p.k. ku administratori i kompanise eshte Eksperti Kontabel i Autorizuar Z.Bashkim Gjata.
Per ekspertizen ligjore te vitit 2007 te behet nga kjo kompani me E.K.A z. Bashkim Gjata. vendosur ne mbledhjen e Asamblese te Keshillit Bashkiak Nr. ____ Date _____.Shpenzimet per zmadhimin e Kapitalit per vitin 2007 jane ato te realizuara per kete qellim ne vitin 2006.
7. Te miratoje Biznes-Planin e vitit 2007.
8. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shoqerise se Tregut.

Kryetari I Keshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE